



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

**Raporti i Akreditimit Periodik Institucional
i Kolegjit Universitar “Qiriazi”**

Prill 2022

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM:

1. Çlirim Duro Kryetar
2. Milazim Gjoca Anëtar

Përmbajtja

Tabela e përmbajtjes

Rreth këtij vlerësimi	4
Konteksti i këtij vlerësimi.....	5
Përmbledhje e raportit.....	6
Përmbledhje e gjetjeve	8
Praktika e mirë	8
Pikat e dobëta.....	Error! Bookmark not defined.
Rekomandimet	Error! Bookmark not defined.
Pohimi i veprimeve të ndërmarra o.....	9
Gjykime përmbledhës për çdo Fushë Vlerësimi	9
Gjykime përmbledhëse.....	9
Raport i detajuar	10
Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij	10
Gjetjet	Error! Bookmark not defined.
Praktika e mirë	13
Pikat e dobëta.....	Error! Bookmark not defined.
Rekomandimet	Error! Bookmark not defined.
Pohimi i veprimeve të ndërmarra o.....	13
Gjykimi	Error! Bookmark not defined.
Fusha e Vlerësimit 2: Burimet.....	14
Gjetjet	Error! Bookmark not defined.
Praktika e mirë	17
Pikat e dobëta.....	Error! Bookmark not defined.
Rekomandimet	Error! Bookmark not defined.
Pohimi i veprimeve të ndërmarra	17
Gjykimi	Error! Bookmark not defined.
Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula.....	18
Gjykimi	Error! Bookmark not defined.
Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi.....	22
Gjetjet	Error! Bookmark not defined.
Praktika e mirë	26
Pikat e dobëta.....	Error! Bookmark not defined.
Rekomandimet	Error! Bookmark not defined.
Pohimi i veprimeve të ndërmarra	26
Gjykimi	Error! Bookmark not defined.
Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre.....	27
Lista e dokumenteve.....	30
Lista A:.....	30
Lista B: Takimet e zhvilluara gjatë vizitës	33
Lista C: Lista e dokumenteve të vëna në dispozicion gjatë vizitës	34

Rreth këtij vlerësimi

Qëllimi kryesor i Vlerësimit Institucional është të vlerësojë se në çfarë mase institucionet e arsimit të lartë (IAL-të) përmbushin Standardet Shtetërore të Cilësisë në Shqipëri, që hynë në fuqi në vitin 2011. Vlerësimi Institucional është procesi i vlerësimit nga Grupi i ekspertëve të Vlerësimit të Jashtëm, që përbëhet nga një ndërthurje e ekspertëve ndërkombëtarë dhe shqiptarë, të caktuar nga ASCAL-i.

Raportet përkatëse nuk shërbejnë vetëm për akreditimin institucional, që bazohet në shkallën e përmbushjes së standardeve nga IAL-i, por edhe për t'u ofruar palëve të interesuara, qeverisë shqiptare, publikut dhe studentëve informacion për mënyrën se si IAL-të i përmbushin këto standarde. Ky raport i ndihmon gjithashtu IAL-të të identifikojnë prioritetet që kanë nevojë për përmirësim (procesi që ofruesit e arsimit të lartë zbatojnë për përmirësimin sistematik të cilësisë së ofrimit dhe mënyrave për mbështetjen e të nxëniet të studentëve).

Standardet Shtetërore të Cilësisë në Shqipëri janë grupuar në pesë kapituj, Fusha Vlerësimi: Organizimi dhe Menaxhimi i tij; Burimet; Kurrikula; Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi; si dhe Studentët dhe Mbështetja e tyre. Ky raport identifikon karakteristikat e praktikave të mira, rekomandimet, pohimet e veprimeve në zhvillim e sipër dhe pikat e dobëta për çdo Fushë Vlerësimi, duke përfshirë gjykimin se në çfarë niveli IAL-ja i përmbush standardet. Format e gjyimit që ekspertët mund të japin janë: standardet janë përmbushur plotësisht; standardet janë përmbushur kryesisht; standardet janë përmbushur pjesërisht; ose standardet nuk janë përmbushur.

Në fund, ekspertët do ta përmbyllin punën e tyre duke i rekomanduar Bordit të Akreditimit të ASCAL-it një gjykim të përmbledhur. Gjykimi i përmbledhur është një nga katër nivelet e mëposhtme:

- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur kryesisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur pjesërisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë nuk janë përmbushur.**

Në kuadrin e procesit të përgatitjes së raportit, ASCAL -i i ka ofruar Grupit të Vlerësimit të Jashtëm mbështetje të specializuar, duke u siguruar që grupi t'i mbështesë gjetjet në raportme fakte, si dhe duke korrigjuar dhe përmbledhur raportin e plotë për përmbledhjen që vijon.

Konteksti i këtij vlerësimi

Kolegji Universitar “Qirjazi” (KUQ) është një institucion i arsimit të lartë jopublik i cili ofron, programe profesionale, nivele studimi të ciklit të parë dhe të dytë në fushat e turizmit, shkencave arsimore, sociale dhe sportive, teknologjisë ushqimore, teknologjisë së informacionit, kontabilitet, menaxhim biznesi dhe financiar dhe drejtësi. Studentët e suksesshëm pajisen një diplomë profesionale, bachelor, Master i Shkencave ose Master i Studimit Profesional.

KUQ u themelua në vitin akademik 2006/07 si shkollë e mesme universitare private “Sevasti dhe Parashqevi Qirjazi”, me qëllimin kryesor për t'u ofruar studentëve një arsim cilësor që pasqyron rezultatet e kërkimit të vazhdueshëm shkencor dhe përpjekjeve për të përdorur arritjet më të mira shkencore në fushat e studimit, që ky institucion ofron. Në vitin 2017, me miratimin e statutit të ri nga Ministria e arsimit, këtij institucioni iu dha emri Kolegji Universitar “Qirjazi”. Në vitin 2018, KUQ-së iu dha leja për hapjen e një Kolegji të Lartë Profesional, si njësi kryesore, qëllimi i së cilës është të ofrojë programe profesionale 2-vjeçare në fushën e teknologjisë ushqimore dhe teknologjisë së informacionit. Ndryshimet e fundit të strukturës dhe statutit të Kolegjit u miratuan në vitin 2021 nga ministria përgjegjëse për arsimin. Kolegji u akreditua për herë të fundit në maj të vitit 2018 për një periudhë 2-vjeçare.

Në kohën kur u krye ky vlerësim, Kolegji përbëhej nga katër njësi kryesore (3 Fakultete dhe 1 Kolegj i Lartë Profesional): Fakulteti i Ekonomisë (Departamenti i Menaxhimit të Biznesit; Departamenti i Financave), Fakulteti Juridik (Departamenti i së Drejtës Civile dhe të Drejtës së Biznesit; Departamenti i Publikut dhe E Drejta Administrative), Fakulteti i Edukimit, Shkencave Sociale dhe Sporteve (Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve; Departamenti i Edukimit, Shkencave Sociale dhe Sportit) dhe Kolegji i Lartë Profesional (Departamenti i Teknologjisë së Informacionit; Departamenti i Teknologjisë Ushqimore dhe Turizmit). Çdo fakultet ka gjithashtu një qendër kërkimore shkencore. Krahas këtyre, ky institucion ka edhe disa njësi administrative.

Përmbledhje e raportit

Në kohën kur u krye ky vlerësim, Kolegji kishte gjithsej 91 punonjës të personelit të mësimdhënies akademike, nga të cilët, 73 staf akademik me kohë të plotë dhe 18 me kohë të pjesshme. Ky kolegji ofron tre programe profesionale; pesë programe studimi të ciklit të parë (bachelor) dhe shtatë programe studimi të ciklit të dytë (katër master të shkencave dhe tre master profesional). Numri i përgjithshëm i studentëve për vitin akademik 2020-2021 është 249.

KUQ-ja u akreditua më parë me vendim të Bordit të Akreditimit, për një periudhë 2-vjeçare. Institucionit iu dhanë 10 rekomandime. 6 muaj pas nxjerrjes së vendimit, KUQ-ja përgatiti një plan veprimi për adresimin e rekomandimeve. Në kohën kur u krye ky vlerësim, Kolegji kishte përmbushur shumicën e tyre dhe po vinte në zbatim rekomandimet e tjera.

Raport i Vetëvlerësimit u përgatit nga një Grup Pune për Vetëvlerësimin e Brendshëm që përfaqëson çdo fakultet, njësi mbështetëse dhe një përfaqësues të studentëve. Draftet iu vunë në dispozicion një audience më të gjerë brenda institucionit përpara se të finalizoheshin. Senati Akademik priti publikimin e raportit përfundimtar dhe dorëzimin e tij pranë Agjencisë.

Vizita u krye gjatë dy ditëve, më 22 dhe 23 nëntor 2021. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm përbëhej nga një anëtar i arsimit të lartë me përvojë nga institucioni i arsimit të lartë të Kosovës dhe një vlerësues i lartë i arsimit të lartë nga Shqipëria. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u mbështet nga Menaxheri i Vlerësimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL).

Grupit të vlerësimit të jashtëm iu vu në dispozicion Raporti i Vetëvlerësimit dhe portofoli i dokumenteve mbështetëse disa javë përpara vizitës së vlerësimit. Më vonë këto materiale u plotësuan me dokumentacionin shtesë të kërkuar para dhe gjatë vizitës. Falë informacionit mbështetës të ofruar nga Kolegji, grupit të vlerësimit të jashtëm iu dha mundësia të njihesh me strukturën, politikën, procedurat e menaxhimit dhe natyrën e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore të ndërmarrë. Dokumentacioni i vënë në dispozicion përfshinte Statutin dhe Rregulloren, raportet e brendshme, raportin vjetor të dorëzuar pranë Ministrisë, procedurat e pranimi dhe orientimit, listën e marrëveshjeve të jashtme dhe memorandumet, shembuj për informacionet rreth programeve dhe dokumentacionet përkatëse të takimeve konsultative.

Gjatë vizitës së vlerësimit, Grupi i vlerësimit të jashtëm u takua me menaxherë të lartë, studentë, lektorë, personelin administrativ dhe mbështetës, si dhe partnerë të jashtëm. Në diskutimet e zhvilluara u qartësuan më mirë procedurat, përgjegjësitë dhe gjetjet. Gjatë të gjitha takimeve u mbajtën shënime. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, si pjesë të vizitës në kolegji, vizitoi bibliotekën, auditorët, laboratorët dhe zyrat.

Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë **përmbushur plotësisht**. Në arritjen e këtij gjykimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk vuri në dukje asnjë karakteristikë të praktikave të mira ose pohoi asnjë veprim të planifikuar nga institucioni. Nuk identifikoi asnjë pikë të dobët dhe nuk dha asnjë rekomandim.

Standardet për Burimet janë **përbushur kryesisht**. Në arritjen e këtij gjykimi, grupi i vlerësimit të jashtëm nuk vuri në dukje asnjë karakteristikë të praktikës së mirë, por pohon një veprim që është në realizim e sipër, siç është, ndërtimi dhe zgjerimi i mjediseve të Kolegjit, duke ofruar më tepër hapësira edukative dhe relaksuese. Megjithatë, u identifikuan dy **pika të dobëta**: Mungesa e literaturës së përditësuar, një sistem efektiv në formën e katalogut dhe mungesa e aksesit në burimet elektronike në bibliotekë për personelin dhe studentët, hapësirat dhe pajisjet e pamjaftueshme laboratorike për të përbushur nevojat e numrit në rritje të studentëve. Grupi i vlerësimit të jashtëm bëri 2 rekomandime për adresimin e pikave të dobëta të identifikuara dhe një rekomandim për përmirësimin e raportit mes studentëve dhe personelit akademik.

Standardet për kurrikulën janë **përbushur plotësisht**. Në arritjen e këtij gjykimi, grupi i vlerësimit të jashtëm nuk ka vërejtur asnjë karakteristikë të praktikës së mirë apo nuk ka pohuar asnjë veprim të planifikuar nga institucioni. Nuk u identifikua asnjë dobësi dhe nuk u dha asnjë rekomandim.

Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë plotësuar kryesisht. Në arritjen e këtij gjykimi, grupi i vlerësimit të jashtëm vuri në dukje karakteristika të praktikës së mirë, siç është hapja e Kolegjit Profesional, duke ofruar programe profesionale. Megjithatë, u evidentuan tri pika të dobëta: Mungesa e një procedure të mirë-projektuar për të mbështetur personelin akademik në kërkime dhe për të shpërndarë fondet e kërkimit; Numër shumë i ulët i publikimeve nga personeli akademik dhe asnjë prej këtyre studimeve nuk janë publikuar në revista me faktor ndikimi, mungesa e metodologjive të trajnimit kryesisht për personelin akademik të sapoemëruar, dhe mungesa e procedurave të vazhdueshme të trajnimit për personelin e vjetër. Grupi i vlerësimit të jashtëm bëri 3 rekomandime për adresimin e pikave të dobëta të identifikuara dhe një rekomandim lidhur me përfshirjen e studentëve të ciklit të dytë në punën kërkimore të personelit akademik.

Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë **përbushur plotësisht**. Në arritjen e këtij gjykimi, grupi i vlerësimit të jashtëm nuk vuri në dukje asnjë karakteristikë të praktikës së mirë ose nuk pohoi asnjë veprim të planifikuar nga institucioni. Nuk u identifikua asnjë dobësi dhe nuk u dha asnjë rekomandim.

Vlerësimi në Kolegj u krye në përputhje me udhëzimet e ASCAL-it. Grupi i vlerësimit të jashtëm e vlerësoi nivelin e angazhimit të Kolegjit në procesin e vlerësimit dhe bashkëpunimin që iu ofrua grupit të vlerësimit të jashtëm gjatë gjithë fazës së vizitës. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm përbëhej nga një anëtar i arsimit të lartë me përvojë nga Shqipëria (vlerësuesi kryesor) dhe një anëtar nga Kosova. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u mbështet gjatë këtij procesi nga Menaxheri i Vlerësimit të emëruar nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL).

Përmbledhje e gjetjeve

Praktika e mirë

Grupi i vlerësimit të jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- Hapja e Kolegjit Profesional, që ofron programe profesionale. **(Kapitulli I, Standardi II.1)**

Pikat e dobëta

Pikat e dobëta të identifikuara nga Grupi i vlerësimit të jashtëm janë si më poshtë:

- Mungesa e literaturës së përditësuar, një sistemi efektiv me katalogje dhe mungesa e aksesit në burimet elektronike në bibliotekë për personelin dhe studentët **(Kapitulli III, Standardi VII.4)**.
- Hapësira dhe pajisje laboratorike të pamjaftueshme për të përmbushur nevojat e numrit në rritje të studentëve **(Kapitulli III, Standardi VII.2)**
- Mungesa e një procedure të mirë-projektuar për mbështetjen e personelit akademik në kërkime dhe shpërndarjen e fondeve të kërkimit. **(Kapitulli II, Standardet I.8)**
- Numri shumë i ulët i publikimeve nga personeli akademik, dhe asnjë prej këtyre studimeve nuk janë publikuar në revista me faktor impakti. **(Kapitulli II, Standardet I.7)**
- Mungesa e metodologjive të trajnimit kryesisht për personelin akademik të sapoemëruar dhe mungesa e procedurave të trajnimit të vazhdueshëm për personelin e vjetër. **(Kapitulli I, Standardi II.4)**

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- Kolegji duhet të vazhdojë të përpiqet që të të rishikojë, përditësojë dhe pasurojë stokun të bibliotekës, të ndërtojë dhe zbatojë një sistem efektiv të katalogimit të bibliotekave dhe t'u sigurojë studentëve dhe personelit akses në burimet elektronike brenda bibliotekës në mënyrë që të adresojë plotësisht rekomandimin e lënë edhe në akreditimin e mëparshëm. **(Kapitulli III, Standardi VII.4)**.
- Institucioni duhet të krijojë më tepër hapësira laboratorike, të ndërtojë laboratorë të rinj për të përballuar numrin në rritje të studentëve dhe për t'i pajisur ata me infrastrukturën e nevojshme. **(Kapitulli III, Standardi VII.2)**
- Rekomandohet që Kolegji të hartojë një procedurë për mbështetjen e personelit akademik dhe për shpërndarjen e fondit të kërkimit. **(Kapitulli II, Standardet I.8)**
- Grupi i vlerësimit të jashtëm rekomandon që personeli akademik, me mbështetjen edhe të institucionit, të bëjë përpjekje më të mëdha në botimin e artikujve, veçanërisht në revista me faktor ndikimi. **(Kapitulli II, Standardet I.7)**
- Grupi i vlerësimit të jashtëm rekomandon që institucioni të ketë një procedurë të mirë-projektuar për metodologjitë e trajnimit të personelit të sapoemëruar dhe

gjithashtu të krijojë mundësi për trajnimin e stafit akademik të vjetër. **(Kapitulli I, Standardi II.4).**

- Për të pasur një raport më të mirë student/personel akademik, grupi i vlerësimit të jashtëm i rekomandon Kolegjit të punësojë staf akademik të kualifikuar me kohë të plotë. **(Kapitulli III, Standardi IV.3)**
- Grupi i vlerësimit të jashtëm rekomandon një përfshirje më të gjerë të studentëve, veçanërisht studentëve të ciklit të dytë të studimeve, në punën kërkimore të personelit akademik. (Kapitulli II, Standardet I.7)
- Institucioni duhet të forcojë lidhjen e internetit pa kabëll në institucion. **(Kapitulli I Standardi III.2).**

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i vlerësimit të jashtëm bëri një pohim për veprimin e ndërmarrë si më poshtë:

- Ndërtimi dhe zgjerimi i mjediseve të Kolegjit, duke ofruar më shumë hapësira edukative dhe relaksuese. **(Kapitulli III, Standardi VII.3; Kapitulli III, Standardi VII.5; Kapitulli III, Standardi V.1).**

Gjykimet përmbledhëse për çdo Fushë Vlerësimi

1. Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë **përbushur plotësisht.**
2. Standardet për Burimet janë **përbushur kryesisht.**
3. Standardet për Kurrikulën janë **përbushur plotësisht.**
4. Standardet për Mësimdhënien, të Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë **përbushur kryesisht.**
5. Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë **përbushur plotësisht.**

Gjykimi përmbledhës

Grupi i Vlerësuesve të Jashtëm i rekomandon Bordit të Akreditimit që Kolegji Universitar “Qiriaz” i përbush kryesisht Standardet Shtetërore të Cilësisë.

Raporti i detajuar

Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij

- 1.1 Kuadri i qeverisjes dhe kuadri rregullator i Kolegjit janë hartuar që të jenë në përputhje me kërkesat ligjore kombëtare për institucionet e arsimit të lartë. Në Statut përcaktohet misioni, organizimi i brendshëm dhe strukturat e menaxhimit të Universitetit. **[A1]**. Përgjegjësitë individuale dhe formale të bordit dhe këshillit janë gjithashtu të parashikuara në rregullore. **[A13; A14.1; A14.2]**. Institucioni i amendon dhe ndryshon Statutin dhe rregulloret e tij sipas nevojës. Senati ka miratuar Statutin dhe rregulloret e ndryshuara me qëllim që ato të reflektojnë si duhet strukturën e tij të re dhe këto dokumente janë miratuar nga Ministria përgjegjëse për arsimin. **[A1; A78]**. *(Kapitulli III, Standardi I.1)*
- 1.2 Institucioni është organizuar për të siguruar menaxhim të frytshëm dhe efikas në përputhje me kërkesat legjislative. Personeli konfirmoi se fluksi i informacionit që përcillet nga departamentet në Senat, dhe shpallja e vendimeve të marra nga Senati për stafin dhe studentët, është efektiv. **[BM5; BM6; BM9]** Marrëveshjet për menaxhimin dhe administrimin e institucionit dhe për vendimmarrjen kolegjiale, parashikojnë pritshmëritë ligjore, funksionojnë siç duhet dhe janë të kuptueshme për personelin e të gjitha niveleve. **[BM10]**. *(Kapitulli III, Standardi I.2)*
- 1.3 Organet drejtuese dhe ato të administrimit mbledhen rregullisht dhe materialet për pikat e rendit të ditës i vihen në dispozicion paraprakisht të gjithë personelit në mënyrë elektronike. **[A1; BM5; BM6]** Studentët dhe personeli treguan se çështjeve të ngritura prej tyre u jepet vëmendja e duhur nga bordet dhe këshillat përmes debatit konstruktiv. Personeli dhe studentët i kuptojnë marrëveshjet për funksionimin e këshillave dhe bordeve konsultative, dhe për mbështetjen e diskutimit dhe debatit kolegjial. **[BM3; BM4]**. Dekanët dhe drejtuesit e departamenteve janë përgjegjës për monitorimin në nivel lokal të zbatimit të vendimeve të marra nga bordet dhe këshillat e formuara zyrtarisht. **[A1; A13; BM9]**. *(Kapitulli III, Standardi I.3)*
- 1.4 Kolegji siguron që të respektohen kufijtë e autonomisë së tij dhe të funksionojë brenda kufijve të parashikuara nga ligjet dhe rregulloret në fuqi. **[A1; A13; BM2]** Stafi tregoi se vetëqeverisja është e dukshme në njësitë organizative, akademike dhe administrative, aktivitetet mësimore dhe shkencore, çështjet financiare dhe administrative. **[BM5; BM6]** Institucioni pretendon se Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë luan një rol kyç në monitorimin dhe analizimin e rezultateve të performancës akademike dhe kërkimore, si dhe të efektivitetit të aktiviteteve të vlerësimit të brendshëm. **[A55; BM6; BM12]** Është ngritur një kornizë gjithëpërfshirëse, janë përcaktuar parime të përgjithshme të vlerësimit, roli i Grupeve të Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë përfshirë anëtarësimin e studentëve dhe një udhëzues i detajuar për vlerësimet dhe raportimin e tyre. Gjithashtu është krijuar një formular për të lehtësuar mbledhjen vjetore të të dhënave nga stafi **[A2; A3]**. Kolegji fton konsulentë të jashtëm nga organet publike dhe kompanitë private për të mbështetur diskutimet në mbledhjet formale dhe joformale. **[BM11]** Institucioni pretendon se Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë, Pranimet dhe Këshillimit të Karrierës ngritur dhe funksionon si duhet për të siguruar që Kolegji të përfitojë financime nga programet evropiane. **[A13; BM6]** *(Kapitulli III, Standardi I.4)*

- 1.5 Institucioni ka një strategji të përshtatshme zhvillimi, e cila është miratuar nga Senati dhe Bordi i Administrimit. **[A40]** Strategjia është hartuar në përputhje me misionin dhe objektivat e Kolegjit dhe është shqyrtuar nga organet drejtuese dhe këshillat gjatë fazave të ndryshme të zhvillimit të saj. **[A1; A40]. (Kapitulli III, Standardi I.5)**
- 1.6 Në raportin vjetor që depozitohet pranë Ministrisë, jepen të dhëna për programet mësimore dhe studimore, kërkimit shkencor, personelit, aktivitetit të projektit dhe çështjeve ekonomike dhe financiare. **[A67]** Procesi i hartimit udhëhiqet nga Dekanët e fakultetit dhe mbështetet gjithashtu në vlerësimin e brendshëm dhe raportet e vetëvlerësimit të përgatitura për aktivitetet e departamentit dhe programit të studimit. Raporti përfundimtar u vihet në dispozicion bordeve dhe komiteteve përkatëse të të gjithë institucionit, ndërsa personeli dhe studentët mund ta gjejnë atë lehtësisht në faqen e internetit. **[BM9; BM10; RVV]. (Kapitulli III, Standardi I.6)**
- 1.7 Fakultetet dhe departamentet janë të organizuara në përputhje me kërkesat ligjore. **[A1; A13; RVV]** Strukturat drejtuese, ekzekutive dhe administrative janë të ndara nga strukturat akademike dhe njësitë organizative **[A76; A77]**. Personeli akademik ka kualifikimin e duhur dhe ushtron autonominë e KUQ-së dhe lirinë akademike në mësimdhënie, kërkime dhe të gjitha aktivitetet e tjera akademike. **[A42; BM5; BM9]** Kolegji ka një faqe zyrtare interneti. Ai ofron programe profesionale, programe të ciklit të parë dhe të dytë në përputhje me statusin e tij ligjor. **[A1; A31; <https://qiriaz.edu.al/>]** **(Kapitulli III, Standardi II.1)**
- 1.8 Kolegji ka një rrjet partnerësh në nivel kombëtar dhe rajonal, në të cilin përfshihen institucionet e arsimit të lartë, organet publike dhe kompanitë e pavarura. **[A45; A47; BM11]** Stafi akademik dhe ofruesit e punësimit treguan se ekzistojnë lidhje të forta ndërmjet organizatave, departamenteve dhe programeve lokale dhe rajonale. **[BM11]** Diskutimi me stafin dhe partnerët tregon se kërkimi i tregut ofron informacione të dobishme për zhvillimin e programit, në mënyrë që Kolegji të përmbushë misionin dhe qëllimin e tij. **[A43; BM5; BM11]** Studentët dhe partnerët konfirmuan se institucioni bashkëpunon me një sërë organizatash për t'u ofruar studentëve shërbime dhe praktika. **[A45; BM3; BM4; BM11]** Statistikat e punësimit të të diplomuarve përdoren për të vlerësuar programet e studimit gjatë viteve të fundit. **[A44]** Stafi tregoi se monitorimi i është marrë përsipër nga Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë, Pranimin dhe Këshillimit për Karrierën. **[A55; BM5] (Kapitulli III, Standardi III.1; Kapitulli III, Standardi III.2; Kapitulli I, Standardi II.3)**
- 1.9 Zhvillimi i marrëveshjeve të partneritetit me partnerë jashtë shtetit, mbikëqyrja e bashkëpunimeve lokale dhe rajonale dhe bashkëpunimi me organizata të tjera për t'u ofruar studentëve mundësi praktike profesionale, ndiqet nga Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë, Pranimin dhe Këshillimit të Karrierës. **[A13; A45; RVV] (Kapitulli III, Standardi III.3)**
- 1.10 Kolegji ka lidhur një numër të vogël marrëveshjesh formale, falë të cilave stafit dhe studentëve u jepet mundësia të marrin pjesë në aktivitete ndërkombëtare, në mënyrë që stafi dhe studiuesit e huaj të kryejnë vizita në institucion. **[A45; A46]** Janë hartuar gjithashtu politika për të mbështetur mobilitetin ndërkombëtar të stafit akademik dhe

studentëve, por bashkëpunimi i partneritetit ndërkombëtar dhe shfrytëzimi i mundësive të mobilitetit për stafin dhe studentët, konsiderohet si një fushë që duhet zhvilluar më tepër për personelin e vjetër. **[A46; BM9; RVV]** . Në kohën e vizitës së vlerësimit, në Kolegj nuk kishte asnjë student të huaj të regjistruar. **(Kapitulli III, Standardi III.4)**

Gjetjet

Praktika e mirë

Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë në këtë Fushë Vlerësimi.

Pikat e dobëta

Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk identifikoi asnjë pikë të dobët në këtë Fushë Vlerësimi.

Rekomandime

Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk dha asnjë rekomandim për këtë Fushë Vlerësimi.

Pohimeve të veprimeve të ndërmarra

Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk bëri asnjë pohim për veprimet që janë në proces e sipër në këtë Fushë Vlerësimi.

Gjykimi

Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë përmbushur plotësisht.

Fusha e Vlerësimit 2: Burimet

- 2.1** Kolegji ka një politikë të qartë, të hapur dhe të drejtë rekrutimi që trajton të gjitha kategoritë e personelit akademik dhe joakademik, me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme. Kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit janë përfshirë në rregulloren e brendshme. **[A3; A50; RVV]** Punësimi i personelit mësimor, shkencor dhe administrativ bëhet në përputhje me ligjin nr.9741, “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe akte të tjera ligjore e nënligjore. Vendet e lira të punës dhe kriteret publikohen në faqet e internetit të institucionit. **[<https://qiriaz.edu.al/category/njofitime>]** Institucioni thekson se prioriteti i tij është të rekrutojë të diplomuarit nga universitetet ndërkombëtare si dhe staf akademik me tituj dhe grada shkencore. **[BM2; BM9; RVV]** Zbatimi i kësaj politike ka bërë të mundur që institucioni të tërheqë individë me ambicie në fushën e kërkimit dhe/ose individë të angazhuar me grupe të jashtme kërkimore. Politika dhe procedurat e rekrutimit për rekrutimin e personelit kanë inkurajuar gjithashtu përfshirjen e specialistëve të jashtëm dhe specialistëve të administratës publike në mësimdhënie. Organograma e institucionit është publikuar sipas Statutit. **[A1; A76; A77] (Kapitulli III, Standardi IV.1)**
- 2.2** Ndërkohë që institucioni deklaron se një nga prioritetet e tij është integrimi i personelit, nuk ekziston asnjë politikë formale dhe janë organizuar vetëm disa ngjarje sociale dhe konferenca akademike për të mbështetur integrimin e personelit akademik dhe administrativ. Kolegji paguan sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të personelit duke bërë ndalesa nga paga bruto e personelit dhe duke paguar kontributin e tij sipas legjislacionit vendas. **[BM5; BM9]** Studentët janë informuar rreth programeve të studimit përmes përdorimit të disa mjeteve, si, spotet televizive, faqet e internetit dhe vizitat në shkollat e mesme. Kolegji përdor një fushatë marketingu për të informuar studentët e ardhshëm rreth programeve të tij të studimit. Personeli akademik u angazhua gjithashtu në përgatitjen e materialeve informative dhe informimin e studentëve perspektivë. **[A52; A57] (Kapitulli III, Standardi IV.2; Kapitulli III, Standardi IV.4)**
- 2.3** Institucioni inkurajon trajnimin e personelit akademik dhe ofron kurse trajnimi brenda institucionit, si dhe mbështetje për lëvizshmëri jashtë vendit, por sistemi i intranetit të Kolegjit nuk është plotësisht funksional për të mbështetur trajnimin online. **[A53; A63]** Megjithatë, nuk ka asnjë dokument apo evidencë të një qasjeje sistematike për tërheqjen dhe trajnimin e personelit. Institucioni i vlerëson arritjet e personelit akademik përmes përdorimit të mjeteve të ndryshme. Edhe pse Kolegji inkurajon trajnimin dhe promovimin e personelit akademik në universitetet perëndimore, kjo mundësi është shfrytëzuar në mënyrë sporadike, edhe për shkak të situatës së shkaktuar nga COVID-19. Në përgjithësi, grupi i vlerësimit të jashtëm **pohon** veprimet që po ndërmerren për vlerësimin e personelit akademik. Megjithatë, grupi i vlerësimit të jashtëm vëren rënie në numrin e përgjithshëm të personelit akademik të institucionit në lidhje me akreditimin paraprak, pavarësisht se numri i studentëve është më i madh. Për të pasur një raport më të mirë student/personel akademik, grupi i vlerësimit të jashtëm i rekomandon Kolegjit që të punësojë staf të brendshëm të kualifikuar. **[A42] (Kapitulli III, Standardi IV.3)**
- 2.4** Kolegji ka rregulla dhe përgjegjësi të qarta për menaxhimin efektiv të burimeve njerëzore, kryesisht nëpërmjet Zyrës së Burimeve Njerëzore. Rregullat dhe përgjegjësitë

për këtë zyrë janë të parashikuara qartë në Statutin dhe rregulloret e tij. **[A1; A50]** Kjo zyrë merret gjithashtu edhe me proceset e rekrutimit dhe të kontratave të personelit, mbledhjen e të dhënave statistikore dhe ruajtjen e të gjithë dokumentacionit përkatës. Megjithatë, institucioni ka përdorur pak mjete për të vlerësuar efektivitetin e Burimeve Njerëzore. **[A50; BM6] (Kapitulli III, Standardi II.2)**

2.5 Kolegji ka strukturën e duhur për të mbështetur dhe zbatuar politikën e tij financiare. Shpërndarja e burimeve financiare bëhet në përputhje me këtë politikë. Bordi i Administrimit është përgjegjës për formulimin dhe ekzekutimin e buxhetit dhe shpërndarja e fondeve bëhet sipas prioriteteve të rena dakord. Ky institucion ka burime të mjaftueshme për të përmbushur misionin dhe për të ofruar programet aktuale **[BM2; BM10]** Të ardhurat e Kolegjit vijnë kryesisht nga tarifat e studentëve, të cilat janë të ulëta në krahasim me normat e tregut të arsimit të lartë privat, nga aksioneri i tij i vetëm dhe huatë. Në rast se të ardhurat nuk do të rriten, ndoshta nëpërmjet rritjes së numrit të studentëve, ose uljes së konsiderueshme të kostove, ky raport konsiderohet i paqëndrueshëm në terma afatgjatë dhe Kolegji duhet të rishikojë me kujdes modelin e tij të përgjithshëm financiar. **[BM10]** Administratori është përgjegjës për zbatimin e politikës financiare i ndihmuar nga Zyra e Financave dhe e Shërbimeve. Politika financiare shqyrtohet në mënyrë kolegjiale nga Bordi i Administrimit. Rolet ndërmjet Bordit të Administrimit dhe Senatit për ndarjen e buxhetit janë të përcaktuara dhe ndarë në mënyrë të qartë. **[A61; BM9; BM10]**. Vendimet e marra nga Bordi i Administrimit miratohen më pas nga Senati. **[A39]** Kërkesat financiare nga personeli mësimdhënës dhe rekrutimi akademik bien dakord përmes diskutimit të ndërsjellë. **[BM1; BM10]** Kolegji nuk ka ngritur një strukturë për auditimin e brendshëm. Megjithatë institucioni nuk është i detyruar t'i auditojë financat e tij për shkak të kohëzgjatjes së shkurtër të funksionimit, një auditor i pavarur është emëruar për këtë qëllim. **[A61]**. **(Kapitulli III, Standardi VI.1; Kapitulli III, Standardi VI.2; Kapitulli III, Standardi VI.3)**

2.6 Kolegji ka prezantuar një sistem informacioni, me qëllim që t'u ofrojë studentëve dhe personelit akses në një sërë informacionesh në lidhje me programet e studimit, rezultatet e vlerësimit dhe informacione të tjera përkatëse. Personeli dhe studentët kanë akses në këtë sistem. **[A66; BM3; BM4]**. Kolegji tregoi se ka zyra të dedikuara për ruajtjen, administrimin dhe shpërndarjen e informacionit. Faqja e internetit e institucionit përdoret për t'i ofruar informacionin e nevojshëm publikut të gjerë. Grupi i vlerësimit të jashtëm vëren se po ndërmerren masa për të vënë plotësisht në funksion një sistem informacioni, falë të cilit studentët do të kenë akses në një sërë informacionesh të rëndësishme në lidhje me programet e tyre të studimit. **(Kapitulli III, Standardi VII.1)**

2.7 Për studentët institucioni ka ngritur laboratorë kompjuterash me 30 vende pune. Raporti i një kompjuteri personal për student është afërsisht 1:8. Sallat e leksioneve dhe të seminareve kanë akses në internetin pa kabëll të Kolegjit dhe disa prej tyre janë të pajisura me pajisje të përshtatshme vizuale. **[A66]** Studentët dhe personeli akademik raportuan se kanë akses të mjaftueshëm në kompjuterë dhe pajisjet e tjera që gjenden nëpër auditorë. Sistemi i ngrohjes është i shkëlqyer. **[BM3; BM4; BM5]**. Megjithatë, gjatë vizitës në terren, grupi i vlerësimit të jashtëm konstatoi se ambientet dhe pajisjet laboratorike nuk janë në përpjesëtim me rritjen e numrit të studentëve të institucionit. Për pasojë, grupi i vlerësimit të jashtëm rekomandon që institucioni duhet të

krijojë më shumë hapësira laboratorike, të cilat duhet të pajisen me infrastrukturën e nevojshme për shkak të rritjes së numrit të studentëve. **(Kapitulli III, Standardi VII.2)**

- 2.8 Studentët dhe personeli akademik konfirmuan se burimet përkatëse mësimore janë të disponueshme në bibliotekë dhe në internet. **[BM3; BM4; BM5]** Biblioteka ka afërsisht 1000 kopje librash dhe botime të tjera në kopje fizike. **[A66; FT]**. Pavarësisht përpjekjeve të Kolegjit dhe përmirësimit të lehtë në lidhje me akreditimin periodik, biblioteka e Kolegjit është e vogël, ka një stok të kufizuar librash me disa tekste të vjetruara në anglisht dhe nuk ka libra elektronike. Përveç kësaj, stoku i bibliotekës nuk ruhet, mirëmbahet dhe zhvillohet siç duhet, pasi biblioteka nuk ka ndërtuar dhe aplikuar një sistem katalogimi. Gjithashtu, nuk ka kompjuter që të sigurojë aksesin e internetit në bibliotekë. **[FT]** Mungesa e përditësimit të literaturës, e një sistemi efektiv katalogimi dhe mungesa e aksesit në burimet elektronike për personelin dhe studentët përbën një pikë të dobët. Rekomandohet që Kolegji të rishikojë, përditësojë dhe pasurojë fondin e bibliotekës, të ndërtojë dhe zbatojë një sistem efektiv të katalogimit të bibliotekës dhe t'u sigurojë studentëve dhe personelit akses në burimet elektronike brenda bibliotekës si një çështje urgjente. **(Kapitulli III, Standardi VII.4)**
- 2.9 Institucioni ka zhvilluar një strukturë administrative logjistike dhe ka kryer anketa për të vlerësuar shërbimet logjistike, përfshirë kërkimin e komenteve nga ana e studentëve lidhur me efektivitetin e shërbimeve logjistike dhe të mësimdhënies. **[A55; A74]** **(Kapitulli III, Standardi VII.6)**
- 2.10 Ndërtesa ku zhvillohet mësimi është në pronësi të kolegjit. Mjedisi është i qetë, i mirëmbajtur dhe i vendosur larg zonave industriale. Ai ofron një infrastrukturë të përshtatshme për të kryer funksionet e tij dhe institucioni është duke investuar ende në të. **[FT]** Ndërtesa plotëson kërkesat në lidhje me ndotjen, ngrohjen, akustikën, ndriçimin, kushtet higjienike dhe sanitare për studentët. **[A67; FT]** Institucioni mban një regjistër të aseteve fikse dhe të pasurive të tij të paluajtshme, i cili vërtetohet nga auditimi i jashtëm. **[A67]** Sipërfaqja e përgjithshme e institucionit është rreth 4000 metra katrorë, nga të cilat 1,094,6 metra katrorë janë auditore, 1,700 metra katrorë janë ambiente sportive dhe 63,9 metra katrorë janë përdorur për kanalizimet. Kolegji tregoi se mesatarja e metrave katrorë për student është mbi maksimumin. Meqë institucioni është duke zgjeruar strukturën e tij, ai po planifikon edhe zgjerimin e faciliteteve të tij. **[RVV; A66; FT]** **(Kapitulli III, Standardi VII.3; Kapitulli III, Standardi VII.5; Kapitulli III, Standardi V.1)**
- 2.11 Të gjitha të dhënat mbahen në Zyrën e Arkivit dhe Protokollit. Zyra i ruan të gjitha të dhënat në letër dhe në korrespondencë, si dhe arkivon kopjet e shtypura të të gjitha aktiviteteve thelbësore akademike. **[A55; BM6]**. Të gjitha informacionet përkatëse të studentëve ruhen në zyrat e Sekretarit të Studentëve. Institucioni ka hapur dosje për të gjithë studentët e tij, duke përfshirë detajet mbi aplikimin, pranimin, notat dhe certifikatën e diplomimit. **[A64]** Dokumentet për aktivitetin akademik ruhen si në formë elektronike ashtu edhe në kopje fizike në të gjitha nivelet. **[A70]** **(Kapitulli III, Standardi V.2)**

Gjetjet

Praktika e mirë

Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë në këtë Fushë Vlerësimi.

Pikat e dobëta

Grupi i vlerësimit të jashtëm identifikoi pikët e dobëta si më poshtë:

- Mungesa e përditësimit të literaturës, e një sistemi efektiv katalogimi dhe mungesa e aksesit në burimet elektronike në bibliotekë për personelin dhe studentët **(Kapitulli III, Standardi VII.4)**.
- Hapësira dhe pajisje laboratorike të pamjaftueshme për të përmbushur nevojat e numrit në rritje të studentëve **(Kapitulli III, Standardi VII.2)**

Rekomandime

Grupi i vlerësimit të jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- Kolegji duhet të vazhdojë të përpiqet që të të rishikojë, përditësojë dhe pasurojë stokun të bibliotekës, të ndërtojë dhe zbatojë një sistem efektiv të katalogimit të bibliotekave dhe t'u sigurojë studentëve dhe personelit akses në burimet elektronike brenda bibliotekës në mënyrë që të adresojë plotësisht rekomandimin e lënë edhe në akreditimin e mëparshëm. **(Kapitulli III, Standardi VII.4)**.
- Institucioni duhet të krijojë më tepër hapësira laboratorike, të ndërtojë laboratorë të rinj për të përballuar numrin në rritje të studentëve dhe për t'i pajisur ata me infrastrukturën e nevojshme. **(Kapitulli III, Standardi VII.2)**
- Për të pasur një raport më të mirë student/personel akademik, grupi i vlerësimit të jashtëm i rekomandon Kolegjit që të punësojë staf akademik të kualifikuar me kohë të plotë. **(Kapitulli III, Standardi IV.3)**

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i vlerësimit të jashtëm bëri pohimin e veprimeve të ndërmarra si më poshtë:

- Ndërtimin dhe zgjerimin e ambienteve të Kolegjit, duke ofruar më shumë hapësira edukative dhe relaksuese. **(Kapitulli III, Standardi VII.3; Kapitulli III, Standardi VII.5; Kapitulli III, Standardi V.1)**.

Gjykimi

Standardet për Burimet janë përmbushur kryesisht.

Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula

- 3.1** Kolegji ofron programe studimi të lidhura ngushtë me misionin e tij dhe Strategjinë e Zhvillimit. Strategjia parashikon ofertën aktuale në tregun e arsimit të lartë për zhvillimin e programeve të studimit në fushën e financës, administrim biznesit dhe të drejtën e biznesit, informatikës, edukimit fizik, turizëm etj. dhe aktualisht ofron 15 programe studimi nga të cilat 5 bachelor, 4 master shkencor, 3 master profesional dhe 3 diploma profesionale. **[A1; A4; A40]** Programet e studimit ofrojnë njohuri dhe informacion, si dhe aftësi dhe kompetenca praktike për përgatitjen e specialistëve. **[A20; A21; A31; A34]** Përmbajtja e të gjitha programeve të studimit pasqyrohet te diplomat që u lëshohen studentëve të suksesshëm. **[A4] (Kapitulli I, Standardi I.1; Kapitulli I, Standardi I.3)**
- 3.2** Kolegji ka publikuar informacionin e kërkuar për të gjitha programet e studimit në faqen e tij të internetit. **[<https://qiriaz.edu.al/informatike-ekonomike-dhe-biznesi-bachelor/#>]** Informacioni për programet dhe kriteret e pranimit janë publikuar edhe në platformën U-Albania. **[BM6]** Institucioni mban kontakte me shkollat e mesme duke organizuar takime orientuese me maturantët dhe drejtorët e shkollave të mesme në mbarë vendin. Ngjarje të tilla përdoren për të bërë publike informacionet lidhur me institucionin dhe programet e tij. **[RVV, BM6]** Kolegji përdor edhe rrjetet sociale për t'i ofruar publikut informacione mbi programet e studimit. **[RVV BM6]. (Kapitulli I, Standardi I.1)**
- 3.3** Institucioni ka hartuar dhe zbatuar procedura të qarta aplikimi dhe kriteret e pranimit për studentët. Senati Akademik miraton kriteret e pranimit për çdo vit akademik, të cilat janë në përputhje me kërkesat e Ministrisë. **[A1; A5; BM10]** Programet e studimit organizohen në mënyrë efektive në lidhje me numrin e krediteve, disponueshmërinë e hapësirës mësimore, praktikën mësimore të studentëve dhe të gjitha aspektet e tjera të të nxënies dhe të mësimdhënies. **[A4]** Faqja e internetit të Kolegjit përmban vetëm informacione të shkurtra për programet, por studentët pajisen me një kopje në letër të sylabusit të tyre, i cili plotësohet me leksionet që ofrojnë informacione përmes emailit dhe në fillim të çdo semestri. Në rregulloret e kolegjit parashikohen qartë rregullat e vlerësimit për testimin e aftësive të studentëve. Këto përfshihen gjithashtu edhe në sylabuset përkatëse. Studentët deklaruan se janë në dijeni të të gjitha politikave dhe procedurave përkatëse. **[A13; BM3; BM4] (Kapitulli I, Standardi I.1; Kapitulli I, Standardi I.6)**
- 3.4** Institucioni ofron vetëm studime me kohë të plotë. Megjithatë, oraret e studimeve po bëhen publike në mjediset e institucionit për të plotësuar nevojat e studentëve master. **[ASCAL1. 92; M9]** Siç u theksua në paragrafin 1.4, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është përgjegjëse për vlerësimin e programeve të studimit, por asnjë dokument nuk është vënë në dispozicion për të mbështetur këtë pretendim. **[ASCAL1. 5, Ar.43, f.23-24; ASCAL1.158, Ar.8, p4] (Kapitulli I, Standardi I.2)**
- 3.5** Fokusi i Kolegjit është të ofrojë programe, që pasqyrojnë prirjet lokale dhe kombëtare. **[A1; RVV]** Institucioni nuk ofron programe të përbashkëta diplomash dhe as nuk bashkëpunon me institucione të tjera të arsimit të lartë për të ofruar kurse ose module të përbashkëta. Megjithatë, Kolegji u referohet modeleve akademike ndërkombëtare për të zhvilluar kurrikulat. **[RVV; A4; A29]** Të gjitha programet e studimit organizohen në përputhje me Procesin e Bolonjës, janë të organizuara në module dhe vlerësohen me

kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Akumulimit të Krediteve (ECTS). [A1; RVV] Në fund të çdo programi studimi lëshohet një diplomë së bashku me një shtojcë në gjuhën shqipe dhe angleze, e njohur nga MAS. [A4] (*Kapitulli I, Standardi I.4; Kapitulli I, Standardi I.10*)

3.6 Ngarkesa mësimore e personelit akademik ndahet në përputhje me aktet nënligjore, rregulloret e Kolegjit dhe numrin e kufizuar të studentëve të regjistruar. [A13; C6] Drejtuesi i departamentit bën ndarjen e ngarkesës totale të punës në vit. Megjithatë, ngarkesa mësimore bëhet në përputhje me kërkesat e Ministrisë dhe shpërndarja e ngarkesës mësimore luhet ndërmjet personelit akademik me kohë të plotë, ku merret parasysh grada akademike dhe ngarkesa administrative. Ngarkesa mësimore e personelit individual, kërkimi shkencor dhe angazhimi administrativ janë të harmonizuara me njëra-tjetrën. [BM5; BM6; C6] (*Kapitulli I, Standardi I.5*)

3.7 Programet e studimit të ciklit të parë hartohen në mënyrë të tillë që të diplomuarit të kenë mundësi të futen në tregun e punës ose të vazhdojnë studimet e ciklit të dytë. [A13; A20; A21] Programet e studimit u ofrojnë studentëve njohuri bazë, metoda dhe parime të përgjithshme shkencore, si gjuhë të huaja dhe aftësi kompjuterike. [A13; A20; A34] Studentët janë të informuar dhe janë të vetëdijshëm për ekzistencën e mundësisë për t'i transferuar kreditet ndërmjet programeve. Disa studentë, për shembull, të regjistruar në programet e ciklit të parë, i kanë transferuar studimet e tyre nga institucione të tjera akademike. [A13; BM3; BM3; C19] (*Kapitulli I, Standardi I.7*)

3.8 Kolegji ka një Seksion të Këshillimit Studentor që përfshin Zyrën e Këshillimit Studentor, Zyrën e Transparencës Administrative dhe Alumni. [A102; <https://qiriaz.edu.al/zyra-e-karrieres/>] Lektorët përdorin një sërë metodash alternative mësimdhënieje për të qenë në një linjë me interesat e studentëve. [RVV; A6] Institucioni i jep përparësi personelit akademik që është aktiv në veprimtari kërkimore. [A36; C13] Personeli akademik me kohë të plotë përbën 60 për qind të stafit të angazhuar në programet e ciklit të parë. Ky personel mbulon 75 për qind të ngarkesës mësimore. [A6] (*Kapitulli I, Standardi I.8*)

3.9 Në vitin akademik 2021-2022, 18 persona nga personeli akademik (13 me kohë të plotë dhe 5 me kohë të pjesshme) janë të kategorisë profesor (20.2%), 31 kanë gradën e doktorit (31.9%) dhe 42 janë me Master Shkencor (47.9%). Kolegji thekson se personeli angazhohet rregullisht në kërkime shkencore, por nuk ka publikime në revista me faktor ndikimi. Praktika profesionale dhe hartimi i tezës së studentëve realizohen në bashkëpunim me sektorin privat dhe kompanitë shtetërore. [A73] Kolegji mbledh të dhëna statistikore për punësimin e të diplomuarve. [A44] Në përputhje me kërkesat ligjore, vetëm personeli akademik me gradë shkencore jep mësim në programet e ciklit të dytë. Personeli akademik me kohë të plotë jep mbi 70 për qind të kurrikulës në programet e studimit të ciklit të dytë. [C6] (*Kapitulli I, Standardi I.9*)

3.10 Qëllimi i programeve të studimit është të balancojnë teorinë me praktikën përmes përfshirjes së ushtrimeve praktike, rasteve të studimit dhe orëve laboratorike për të mbështetur leksionet. Partnerët e jashtëm dhanë komente mbi zhvillimin e propozuar të kurrikulës kur pati një ri-prezantim të akreditimit. [BM3; BM4; BM11] Në të gjitha programet e studimit të ciklit të dytë duhet të përgatitet një temë diplome. Në ciklin e parë, vetëm studentët që arrijnë ose tejkalojnë notën mesatare mund t'u caktohet të

përgatisin një tezë. Në programin e studimit dhe rregulloren e Kolegjit janë përcaktuar qartë rregullat dhe standardet për shkrimin dhe vlerësimin e tezës. **[A13; A23] (Kapitulli I, Standardi I.11)**

3.11 Programet e studimit në të dy fakultetet ofrojnë module të veçanta me njohuri nga fusha socio-ekonomike dhe module që lidhen drejtpërdrejt me fushën e specializimit të punësimit. [RVV] Studentët duhet të kryejnë një praktikë të detyrueshme profesionale ose një stazh në programet e studimit bachelor dhe master profesional **[A73]**. Praktika profesionale përfshihet në të gjitha programet e studimit dhe u jep mundësinë studentëve që të punojnë në një biznes apo institucion publik. Institucioni bashkëpunon me partnerë të jashtëm për të mbështetur zbatimin e praktikave të studentëve. Partnerët e jashtëm kontribuuan edhe në zhvillimin e kurrikulës. **[A45; BM11]** Kolegji bën përpjekje për të përditësuar kurrikulat ekzistuese duke përfshirë zyrtarisht partnerë të jashtëm në këtë proces **[RVV; BM11]**. Kohëzgjatja e praktikës është dy javë dhe ajo vlerësohet me katër kredite ECTS. Studentët përgatisin një raport përfundimtar, i cili përshkruan organizatën pritëse, analizon mësimet e nxjerra gjatë praktikës dhe ofron reflektime personale. **[A73] (Kapitulli I, Standardi I.12)**

Gjetjet**Praktika e mirë**

Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë në këtë Fushë Vlerësimi.

Pikat e dobëta

Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk identifikoi asnjë pikë të dobët në këtë Fushë Vlerësimi.

Rekomandime

Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk dha asnjë rekomandim për këtë Fushë Vlerësimi.

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk bëri asnjë pohim të veprimeve që janë në proces në këtë Fushë Vlerësimi.

Gjykimi

Standardet për Kurrikulën janë përmbushur plotësisht.

Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi

4.1 Rregulloret që zbatohen për çdo program studimi miratohen nga Senati. **[RVV; A;20; A21; A23; A29]** Programet e studimit janë të përcaktuara qartë në lidhje me ngarkesat mësimore, vlerësimi, si dhe struktura e tyre gjendet e publikuar. **[A20; A21; A23; <https://qiriaz.edu.al/finance-master-profesional/>]** Përkufizimet përkthehen në manuale gjithëpërfshirëse studentore për çdo modul. Në mënyrë të ngjashme, rregullat për përgatitjen e tezës janë gjithëpërfshirëse dhe të qarta. Për të siguruar uniformitet, për tezat e diplomës ka një model të përbashkët. Kolegji ka një kuptim të mirë të programeve të tij dhe ofrimit të tyre. Programet janë në përputhje me qëllimin e institucionit dhe tregojnë përafrim të fortë me praktikën profesionale. **[A13; BM3; BM4]** Si shembull mund të përmendim programet profesionale që institucioni ka hapur së fundmi. Grupi i vlerësimit të jashtëm e konsideron këtë si një praktikë të mirë, që institucioni të tërheqë një grup të ri studentësh. **[A73; BM11]** Në fillim të çdo viti akademik, departamenti zhvillon diskutime për përmirësimin e kurrikulës dhe metodat e mësimdhënies për vitin e ardhshëm. **[BM9] (Kapitulli I, Standardi II.1)**

4.2 Studentët shprehën në përgjithësi mbështetje për kurrikulat e Kolegjit dhe materialet mësimore të ofruara. **[BM3; BMM4]** Edhe pse personeli i konsideroi burimet e Kolegjit si të përshtatshme dhe, në përgjithësi, ka kapacitet brenda burimeve aktuale fizike për t'i realizuar programet në mënyrë efikase, jo të gjitha auditorët janë të pajisur me pajisje moderne të projektimit. Në një auditor të madh imazhi i projektuar është shumë i vogël dhe nuk mund të shihet nga pjesa e pasme e sallës **[BM5; FT]** Kolegji ka lidhur disa marrëveshje me organizma të jashtëm që u ofrojnë studentëve mundësi për të zhvilluar praktikën e tyre. **[A45; BM11]** Grupi i vlerësimit të jashtëm arriti në përfundimin se praktikatat janë një karakteristikë funksionale e Kolegjit, edhe pse në dy vitet e fundit praktikatat u ndikuan kryesisht për shkak të pandemisë Covid-19. **(Kapitulli I, Standardi II.1)**

4.3 Rregullat dhe kërkesat e provimeve, kriteret dhe procedurat e diplomimit janë të parashikuara në rregulloret e fakultetit, të cilat miratohen nga Bordi i Administrimit dhe Senati. **[A14; A18; A26; A31]** Informacionet për vlerësimin dhe diplomimin janë të afishuara në hyrje të institucionit që studentët të mund të kenë akses të menjëhershëm në to. **[FT]**. Rregullorja e Kolegjit përcakton qartë procesin dhe procedurat për ankesat që studentët kanë për rezultatet e provimeve. **[A13]** Provimet janë anonime dhe studentët mund t'i shikojnë rezultatet e tyre në mënyrë elektronike. **[A64]** Studentët dhe personeli mësimor ishin të vetëdijshëm për të gjitha procedurat e vlerësimit, përfshirë kriteret e diplomimit dhe ankesat. Ata u shprehën se ishin të kënaqur me këto rregullime. **[BM3; BM4]** Certifikatat e diplomës janë të qarta dhe të plota dhe janë në përputhje me kërkesat e rregulloreve të Kolegjit. **[A13; A71] (Kapitulli I, Standardi II.2)**

4.4 Lektorët vlerësohen në fund të çdo semestri përmes pyetësorëve, të cilët plotësohen nga studentët. Këta pyetësorë e përmbushin më së miri këtë qëllim. **[A54; A74]** Raportet përmbledhëse i dorëzohen Dekanit përkatës të Fakultetit. **[A67; BM9]** Në raste kur ka dyshime për performancën, lektori mund të vëzhgohet nga një punonjës tjetër personeli; Sanksionet përfundimtare përfshijnë pezullimin dhe uljen në detyrë. **[BM5; BM9]** Stafi tregoi ndërgjegjësimin për këto sanksione, por deklaroi se cilësia e mësimdhënies nuk ishte vlerësuar kurrë si e ulët. **[BM3]** Modulet vlerësohen në mënyrë të ngjashme duke

përdorur një formular të thjeshtë me tetë pyetje që përfshin më së miri elementet thelbësore të një moduli. **[A54; A74]** Megjithëse rezultatet u paraqiten departamenteve për reflektim dhe veprim, ndryshimet në programe si rezultat i këtij procesi nuk janë aplikuar, sepse Kolegji pretendon se të dhënat ku bazohet gjykimi, nuk janë të mjaftueshme. **(Kapitulli I, Standardi II .3)**

4.5 Trajnimi në mësimdhënie nuk është sistematik as për personelin e ri ose të vjetër. Trajnimet kryhen mbi baza oportuniste. Mungesa e metodologjive të trajnimit për stafin akademik të sapoemëruar, dhe mungesa e procedurave për trajnimin e vazhdueshëm për stafin e vjetër, konsiderohet si pikë e dobët dhe grupi i vlerësimit të jashtëm rekomandon që institucioni duhet të zbatojë një procedurë të mirë-hartuar për metodologjitë e trajnimit të stafit të ri. Gjithashtu, ai duhet t'u japë mundësi për ttajnim dhe stafit akademik të vjetër. **[BM9] (Kapitulli I, Standardi II.4)**

4.6 Kërkimi është shumë i pazhvilluar. Sipas Kolegjit, personeli i vjetër është duke ndërmarrë hapat e tij të parë në veprimtarinë kërkimore. **[BM5; BM9]** Edhe pse Kolegji nuk dekurajon aktivitetin kërkimor, ai nuk menaxhohet apo koordinohet sistematikisht. Megjithëse stafi është i lirë të ndjekë interesat e tij individuale kërkimore, Kolegji nuk menaxhon asnjë projekt kërkimor dhe nuk i është përgjigjur asnjë oferte kërkimore në vitet e fundit, ose nuk ka aplikuar për ndonjë financim për aktivitetet e tij kërkimore shkencore. **(Kapitulli II, Standardet I.1).**

4.7 Në rregulloret e Kolegjit departamenti parashikohet si njësi bazë mësimore-kërkimore, që organizon veprimtari sipas disiplinës përkatëse për të nxitur, koordinuar dhe menaxhuar veprimtaritë mësimore dhe kërkimore. Gjithashtu ajo është përgjegjëse për zhvillimin e tyre. **[A13]** Rregulloret bazohen pjesërisht në Standardet Shtetërore Shqiptare të Cilësisë dhe në to pasqyrohet formulimi i Udhëzimeve Standarde. Veprimtaria e departamenteve bazohet në rregulloret e tyre, të cilat pasqyrojnë ato të Kolegjit dhe të fakultetit. **[A19; A22; A27]** Departamentet mund të organizohen në grupe arsimore, drejtuesit e të cilëve zgjidhen nga një komision i caktuar nga dekani i fakultetit. **[BM9]** Kolegji tregoi se aktiviteti dhe prioritetet kërkimore diskutohen dhe organizohen në mënyrë operative në nivel departamenti, përmes planeve të punës të departamenteve të monitoruara nga drejtuesit e departamenteve, por grupi i vlerësimit të jashtëm nuk arriti të gjente asnjë dokument për të mbështetur këtë pretendim. **[BM9]** Edhe pse departamentet kanë njëfarë autonomie financiare, stafi tregoi se megjithëse Departamentet mund të kërkojnë fonde shtesë, ata nuk kanë liri buxhetore. **[C14]** Qëllimi kryesor i çdo aktiviteti kërkimor në Kolegj është të mbështesë studentët dhe të ofrojë mësimdhënien. **[RVV] (Kapitulli II, Standardet I.2)**

4.8 Kolegji ka emëruar një Drejtues për Qendrën Kërkimore dhe ka lidhur marrëveshje formale me pesë universitete shqiptare dhe dy universitete jashtë shtetit për aktivitete të ndryshme bashkëpunuese që lidhen me kërkimin shkencor. **[RVV; C17]** Këto marrëveshje u lidhën në vitin 2017 dhe tani kanë filluar të tregojnë potencialin e tyre. Pra, bashkëpunimet e forta kërkimore thuajse nuk ekzistojnë, megjithëse Kolegji ka lidhur një marrëveshje me Dhomën e Tregtisë. Gjithsesi, mendohet se rezultat e kësaj marrëveshje mund të jenë të shpejta. **[RVV]** Arritje e institucionit është zhvillimi i një reviste të kolegjit për publikimin e rezultateve të kërkimit. **[<https://qiriaz.edu.al/botime-revista-artikuj-shkencor/>]** Megjithatë, një sipërmarrje e tillë mund të jetë kundër-

produktive në kuptimin që kufizon ekspozimin e kërkimit të Kolegjit ndaj një auditori brenda Kolegjit. **(Kapitulli II, Standardet I.3)**

4.9 Shumica e stafit akademik kanë diploma më të larta si në nivelin master ashtu edhe në atë të doktoraturës. Procesi i përzgjedhjes së stafit të ri akademik përdor një sistem të bazuar në pikë, i cili jep pikë për zotërimin e diplomave më të larta dhe për rezultatet e kërkimit. **[RVV; A42; A50]** Personeli ishte në gjendje të jepte një shembull të rastit kur aktiviteti kërkimor pasur një ndikim në emërim. **[BM5]** Kolegji nuk ka procedura për të mbrojtur pronësinë intelektuale, megjithëse aktiviteti i tij aktual kërkimor nuk ka gjasa të gjenerojë ndonjë. **(Kapitulli II, Standardet I.4)**

4.10 Kolegji organizon konferenca dhe seminare të ndryshme në bashkëpunim me IAL-të e tjera dhe njësitë e tyre. KUQ ka ngritur dhe përmirësuar vazhdimisht infrastrukturën në mbështetje dhe funksion të veprimtarisë kërkimore-shkencore, por kjo nuk ka qenë e mjaftueshme për kërkimin shkencor dhe për të gjeneruar të ardhura. Përveç kësaj, KUQ boton revistën e tij shkencore, në të cilën pasqyrohen zhvillimet më të fundit doktrimore, kërkimore-shkencore. Ajo shërben edhe si pjesë e bibliografisë për kurset e zhvilluara në njësitë e KUQ-së. Megjithatë, nevojitet më shumë angazhim në aspektin e kërkimit. **[<https://qiriaz.edu.al/botime-revista-artikuj-shkencor/>] (Kapitulli II, Standardet I.5)**

4.11 Kolegji është në fazën të hershme të koordinimit të veprimtarisë së tij kërkimore, por ai ka aspirata të konsiderueshme për sa i përket prioriteteve kërkimore, duke mbuluar një gamë të gjerë aktiviteteve të përcaktuara në Planin Strategjik të Zhvillimit. **[RVV; A40]** Institucioni planifikon të rrisë koordinimin nëpërmjet përgatitjes së planeve vjetore të kërkimit, zgjerimit të sipërmarrjeve të jashtme bashkëpunuese, organizimit të konferencave, rekrutimit të personelit aktiv kërkimor dhe inkurajimit të botimeve ndërkombëtare. **[BM2; BM9]** Kjo do të zbatohet përmes identifikimit të nevojave të tregut të punës dhe zhvillimit ekonomik kombëtar, dhe për të përfituar nga mundësitë e partneritetit evropian. **[BM2]** Megjithatë, mjetet me të cilat do të realizohen këto përmirësime nuk ishin të përfshira në ndonjë proces planifikimi ose nuk iu bënë të qarta grupit të vlerësimit të jashtëm. **(Kapitulli II, Standardet I.6)**

4.12 Punimet kërkimore të Kolegjit janë modeste. Për sa i përket personelit të kolegjit, mund të themi se disa prej tyre kanë kryer punime në lidhje me kërkimin, kanë marrë pjesë në konferenca të ndryshme dhe kanë publikuar artikuj në literaturën kombëtare dhe ndërkombëtare, megjithëse shumë pak në revista kërkimore ndërkombëtare. Shumica e tyre janë në gjuhën shqipe. Nuk ka botime në revista me faktor ndikimi. Grupi i vlerësimit të jashtëm rekomandon që stafi akademik, me mbështetjen e institucionit, të bëjë përpjekje më të mëdha të botojë artikuj, veçanërisht në revista me faktor ndikimi. **[<https://qiriaz.edu.al/botime-revista-artikuj-shkencor/>]** Edhe pse punimet në gjuhën shqipe mund të kufizojnë prezantimin e punës, ato mund të vihen në dispozicion të personave që nuk kanë njohuri të mjaftueshme të gjuhës angleze. Pjesëmarrja e stafit në konferenca është e kufizuar vitet e fundit edhe për shkak të situatës së krijuar nga Covid-19, megjithëse ka pasur disa pjesëmarrje jashtë Shqipërisë. **[A46]** Anëtarët e Bordit të Administrimit pohuan se kishte financime për stafin që ky i fundit të merrte në konferenca. Këto fonte i ishin vënë në dispozicion të gjithë pjesëtarëve të stafit që takuam gjatë vizitës. **(Kapitulli II, Standardet I.7)**

4.13 Pranohet se qëndrimi e Kolegjit për fushën e kërkimit është zbutur pjesërisht nga rifillimi i aktiviteteve së fundmi, dhe grupi i vlerësimit vuri re hapat që po ndërmerren për zhvillimin dhe zbatimin e planeve të Kolegjit për koordinimin dhe promovimin e kërkimit në përputhje me planin strategjik të zhvillimit të Kolegjit **[A40]**. Megjithatë, Kolegji nuk ka mjete sistematike për të mbështetur financiarisht personelin në përpjekjet e tyre kërkimore. **[C14]**. Rekomandohet që Kolegji të hartojë një procedurë për mbështetjen e stafit të tij akademik dhe për shpërndarjen e fondeve të kërkimit. *(Kapitulli II, Standardet – I.8)*

Gjetjet

Praktika e mirë

Grupi i vlerësimit të jashtëm identifikoi karakteristikën e mëposhtme të praktikës së mirë:

- Hapja e Kolegjit Profesional, që ofron programe profesionale. **(Kapitulli I, Standardi II.1)**

Pikat e dobëta

Grupi i vlerësimit të jashtëm identifikoi pikat e dobëta si më poshtë:

- Mungesën e një procedure të mirë-hartuar për mbështetjen e stafit akademik në kërkimin shkencor dhe shpërndarjen e fondeve të kërkimit. **(Kapitulli II, Standardet I.8)**
- Numrin shumë të vogël të publikimeve nga personeli akademik, dhe asnjë prej këtyre publikimeve nuk ishte botuar në revista me faktor ndikimi. **(Kapitulli II, Standardet I.7)**
- Mungesën e metodologjive të trajnimit kryesisht për personelin akademik të sapoemëruar dhe mungesa e procedurave për trajnimin e vazhdueshme të stafit të vjetër. **(Kapitulli I, Standardi II.4)**

Rekomandime

Grupi i vlerësimit të jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- Rekomandohet që Kolegji të hartojë një procedurë për mbështetjen e stafit akademik dhe për shpërndarjen e fondit të kërkimit. **(Kapitulli II, Standardet I.8)**
- Grupi i vlerësimit të jashtëm rekomandon që stafi akademik, me mbështetjen e institucionit, të bëjë përpjekje më të mëdha për botimin e artikujve, veçanërisht në revista me faktor impakti. **(Kapitulli II, Standardet I.7)**
- Grupi i vlerësimit të jashtëm rekomandon që institucioni duhet të zbatojë një procedurë të mirë-hartuar për metodologjitë e trajnimit të stafit të sapoemëruar dhe gjithashtu të krijojë mundësi për trajnimin e stafit akademik të vjetër. **(Kapitulli I, Standardi II.4).**
- Grupi i vlerësimit të jashtëm rekomandon një përfshirje më të gjerë të studentëve, veçanërisht studentëve të ciklit të dytë të studimeve, në punën kërkimore të personelit akademik. **(Kapitulli II, Standardet I.7)**

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk bëri asnjë pohim të veprimeve në proces për këtë Fushë Vlerësimi.

Gjykimi

Standardet për Mësimdhëniën, Mësimnxëniën, Vlerësimin dhe Kërkimin janë përmbushur kryesisht.

Fusha e vlerësimit 5: Studentët dhe mbështetja e tyre

- 5.1. Institucioni ndjek politikën e duhur për regjistrimin e studentëve të rinj, kolegji ndjek një politikë korrekte për pranimin e studentëve. Institucioni ka ngritur Degën e Informacionit, Orientimit dhe Karrierës së Studentëve. Grupi i vlerësimit të jashtëm konfirmoi se pavarësisht përkushtimit për të nxitur regjistrimin në Kolegj, ai ngriti për këtë qëllim dhe një komision të posaçëm për këto procedura **[A75]**. Kriteret e pranimit të studentëve për çdo program studimi miratohen paraprakisht nga Senati Akademik **[A72]**. Kolegji ka zhvilluar një turne orientues informativ dhe ka shpërndarë informacione të tjera përmes fletëpalosjeve zyrtare dhe programeve të tjera sociale **[A79]**. Kolegji ka përcaktuar procedurën e pranimit të studentëve që dëshironin t'i transferonin studimet e tyre në programet e studimit pranë këtij institucioni **[A13]**. *(Kapitulli I Standardi III.1).*
- 5.2. Institucioni ndjek një politikë informuese dhe komunikuese me studentët dhe personelin tjetër akademik. Institucioni ka një strukturë informuese dhe këshilluese për studentët dhe partnerët, e cila realizohet përmes faqes zyrtare të internetit **[ëëë.qiriaz.edu.al]** dhe rrjeteve sociale. Në fushën institucionale, çdo lektor menaxhon faqen e tij personale përmes së cilës komunikon me studentët dhe palët e tjera të interesuara. Profesorët, personeli administrativ dhe studentët kanë adresa të unifikuara nën domenin e Kolegjit. Megjithatë, problemet me këtë sistem vazhdojnë të jenë të pranishme dhe kërkohet angazhim më i madh i stafit, me qëllim që të sigurojë lidhje më të mirë interneti pa kabëll. Sekretaria mësimore bën publik procesin e pranimit dhe numrin e vendeve të lira. **[A64]**. Në rregulloren e Kolegjit parashikohen kriteret se studentët duhet të informohen vazhdimisht, por në të njëjtën kohë, duhet të sigurohet edhe mbrojtja e të dhënave personale të studentit **[A13]**. *(Kapitulli I Standardi III.2).*
- 5.3. Kolegji ndjek një politikë të orientimit dhe këshillimit të studentëve; përmes së cilës institucioni angazhohet që t'u japë informacion dhe t'i orientojë studentët në karrierën e tyre **[A13]**. Kjo zyrë ofron materiale informative dhe broshura me qëllim informimin e studentëve. KUQ-ja ofron përmes OERACC-it shërbime këshillimi për karrierë, si dhe informacione rreth mundësive të punësimit, trajnimeve të praktikës profesionale, seminareve dhe aktiviteteve të tjera me të njëjtin qëllim. **[A103]** *(Kapitulli I Standardi III.3).*
- 5.4. Institucioni ka një politikë mbështetëse për kategori të veçanta sociale. Me kalimin e viteve, KUQ-ja i ka trajtuar me bursë studentët me rezultate të larta dhe studentët e tjerë të kategorizuar social. Bazuar në vizitën në terren në mjediset e KUQ-së, u vërejt se infrastruktura për studentët me aftësi të kufizuara është pjesërisht e mjaftueshme. Institucioni është i vetëdijshëm për këtë situatë dhe po punon për përmirësimin e saj. Për studentët që merren me aktivitete sportive, institucioni ndjek një politikë mbështetëse dhe mjediset e Fakultetit të Edukimit Sportiv po vihen në dispozicion edhe të studentëve të tjerë. **[A37]**. *(Kapitulli I Standardi III.4).*
- 5.5. Institucioni ofron literaturë bazë për studentët. Biblioteka e KUQ-së konsiderohet të jetë një njësi që duhet të ofrojë mbështetje për procesin e kërkimit shkencor si dhe për procesin e mësimdhënies dhe të të nxëniet brenda hapësirës universitare **[A13]**. Biblioteka ofron literaturë multidisiplinare dhe është e hapur nga e hëna në të premte nga ora 9 e mëngjesit deri në orën 16: 30. Biblioteka nuk ka mjaftueshëm sasi dhe tituj,

por KUQ-ja e pasuron vazhdimisht bibliotekën e tij **[A48]**. Laptopët mund të përdoren në bibliotekë dhe aksesit në internet si për studentët ashtu edhe për personelin mësimor, ofrohet falas. Të gjithë studentët dhe personeli mësimor pajisen me kartë individuale regjistrimi me qëllim që librat të jenë të monitoruar dhe të përdoren konsiderueshëm prej tyre. **[BM3; BM4; BM5] (Kapitulli I Standardi III.5)**

- 5.6. Institucioni ofron mbështetje për studentët e ciklit të parë përmes shërbimit universitar me qëllim për të lehtësuar përparimin e tyre. KUQ ofron mbështetje studentëve përmes shërbimeve universitare për t'i udhëzuar ata në gjetjen e literaturës përkatëse për çdo modul. Personeli akademik ofron edhe kurse këshillimi për studentët që hasin vështirësi të ndryshme gjatë studimeve. Këto aktivitete kryhen me ndërmjetësimin e tutorëve/mentorëve të cilët ndihmojnë në orientimin e studentëve drejt programeve të studimit. Studentëve të regjistruar në programet e studimeve profesionale u ofrohen lehtësitë e mëposhtme: Dy laboratorë IT, laborator elektronik dhe informativ, laborator modern kimi-ushqimor, kabinet bashkëkohor hoteleri-turizmi etj. **[A79; BM3; BM4; BM5].(Kreu I Standardi III.6).**
- 5.7. Institucioni inkurajon pjesëmarrjen e studentëve në jetën institucionale. KUQ siguron një përfaqësim solid të studentëve në jetën institucionale duke siguruar vende në organet kryesore drejtuese si Senati, Bordi i Drejtorëve, Komiteti i Sigurimit të Cilësisë, Programet e Kërkimit dhe Hulumtimit, Komiteti i Etikës, etj. në përputhje me kuadrin ligjor të arsimit të lartë **[A1]**. Institucioni i mbështet studentët për funksionimin e këshillave studentore, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi (Ligji për Arsimin e Lartë 80/2015, neni 99, pika 6). Institucioni ka mbështetur rregullisht Këshillin Studentor duke vënë në dispozicion të studentëve mjediset e tij pa pagesë, duke organizuar leksione të hapura dhe duke financuar aktivitetet e tyre **[A48; A57]. (Kapitulli I Standardi III.7)**
- 5.8. Institucioni mbështet rritjen e cilësisë së jetës së studentëve, përmes aktiviteteve jashtëshkollore, si aktivitete kulturore, sportive, panairë, udhëtime turistike të garantuara në dokumentet e vëna në dispozicion nga KUQ **[A58; BM3; BM4]**. Këto aktivitete i kryejnë vetë nxënësit dhe ofrojnë informacione në kohë reale. Të gjitha këto aktivitete bazohen në organizime të tilla si: Këshilli Studentor, Forumi Ekonomik, Klubet Letrare, Klubi i Futbollit, etj. **[BM3; BM4] (Kapitulli I Standardi III.8)**
- 5.9. Institucioni favorizon punësimin e studentëve. Institucioni ka të dhëna statistikore për punësimin e studentëve të diplomuar pranë fakulteteve të tij. **[A44]**. Personeli i Zyrës së Karrierës i u jep këshilla individuale studentëve për çështjet e punësimit (*p.sh. si të shkruajnë një bibliografi, si të gjeni informacione punësimi, si të sillen gjatë intervistës, etj.*) KUQ është e angazhuar të mbështesë studentët e diplomuar, veçanërisht studentët ekselentë, duke i rekomanduar ata pranë një punëdhënësi ose duke i marrë në punë. **[A44; BM6]. (Kapitulli I Standardi III.9)**

Gjetjet

Praktika e mirë

Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë.

Pikat e dobëta

Grupi i vlerësimit identifikoi pikat e dobëta si më poshtë.

Rekomandime

Grupi i vlerësimit dha rekomandimet e mëposhtme:

- Institucioni duhet të forcojë lidhjen e internetit pa kabëll brenda institucionit. (**Kapitulli I Standardi III.2**).

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk vërejti asnjë pohim të veprimeve në proces për këtë Fushë Vlerësimi.

Gjykimi

Standardet për studentët dhe mbështetjen e tyre janë përmbushur kryesisht.

Lista e dokumenteve

- Letër motivuese _AL.pdf
- Vetë-deklarimi i Rektorit _AL.pdf
- Raporti i Vetëvlerësimit të Kolegjit Universitar “Qiriaz” ENG.pdf
- Raporti i Vetëvlerësimit të Kolegjit Universitar “Qiriaz” AL-SQ.pdf

Lista A:

Lista e dokumenteve të vëna në dispozicion si pjesë e dokumenteve të vetëvlerësimit, aneksi për RVV-in. Këto dokumente mbi QAA janë referuar duke përdorur shkurtesën **A1.1...**, **A 2.40.**, etj.

Shtojcat në gjuhën shqipe:

1. Statuti KUQ.pdf
2. Vendimi i Senatit për ngritjen e GVB institucional.pdf
3. Plan Pune i GVB.pdf
4. Programet e studimit dhe diplomat në KUQ_2020-2021.pdf
5. Aktet nënligjore për KUQ.pdf
6. Urdhërat e MASR per hapjen e KPL dhe programeve TI&TU&HT.pdf
7. Urdhërat e MASR për riorganizimin e disa programeve.pdf
8. Vendime të Bordit për akreditim të disa programeve.pdf
9. U_MASR Nr 214, dt 14.07.2021.pdf
10. Urdhër MASR 262 date 19.07.2021.pdf
11. Urdhër MASR 263 date 19.07.2021.pdf
12. Urdhër MASR 273 date 21.07.2021.pdf
13. Rregullore e KUQ.pdf
14. Rregullore e Fakultetit të Drejtësisë.pdf
15. Rregullore e Funkcionimit të Rektoratit.pdf
16. Rregullore e Këshillit të Etikës.pdf
17. Rregullore e Asamblesë së Personelit Akademik_FD_FE.pdf
18. Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë.pdf
19. Rregullore e Departamentit të Menaxhim Biznesit.pdf
20. Rregullore e Program Studim_FE_BCH_MB.pdf
21. Rregullore e Program Studimi_FE_BCH_Drejt_Fin.pdf
22. Rregullore e Departamentit të Financës.pdf
23. Rregullore e Program Studim_FE_Msc_Admin_Biznes.pdf
24. Rregullore e qendrës se kërkimit shkencor te FE.pdf
25. Rregullore e Programit te Studimit 'Finance', MSC, FE.pdf
26. Rregullore e Fakultetit të Drejtësisë.pdf

27. Rregullore e Departamentit të së Drejtës Civile dhe Biznesit.pdf
28. Rregullore e të Drejtës Publike dhe Administrative.pdf
29. Rregullore e programit_MPJDB_MP.pdf
30. Rregullore e qendrës së kërkimit shkencor te FD.pdf
31. Rregullore Kolegjit Profesional të Lartë 2019.pdf
32. Rregullore e Departamentit TI.pdf
33. Rregullore departamentit TUT 2020.pdf
34. Rregullore e programit Hoteleri-Turizem.pdf
35. Rregullorja e Asamblesë së KPL.pdf
36. Rregullore Fakultetit të Edukimit, Shkencave Sociale dhe Sporteve.pdf
37. Rregullore e Departamentit të Edukimit, Shkencave Sociale dhe Rekreacionit Sportiv.pdf
38. Rregullore e Qendrës së Kërkimit Shkencor.pdf
39. Rregullorja e Senatit Akademik.pdf
40. Plani Strategjik i zhvillimit të KUQ.pdf
41. Shkresa Nr_317 dt.29.12.2020 e KUQ për MASR “Dërgim raporti vjetor i KUQ 2019-2020.pdf
42. Tabela mbi numrin dhe kualifikimin shkencor të personeli të KUQ.pdf
43. Studim i tregut të punës për programin Bachelor në “Manaxhim Biznesi”.pdf
44. Statistikë mbi diplomimin e studentëve dhe punësimin e tyre në këto tre vite1.pdf
45. Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet homologe dhe aktorët e biznesit, brenda e ose jashtë vendi.pdf
46. Politikat e kërkimit shkencor. Puna kërkimore-shkencore kater vjeçare në KUQ.pdf
47. Kontrata me te trete.pdf
48. Vendim Bordi pagesat për konferenca e pajisjen e bibliotekës.pdf
49. Te dhënat e aktiviteteve për kualifikim dhe kërkim shkencor te stafit akademik 4 vitet e fundit.pdf
50. Rregullore e zyrës së burimeve njerëzore protokoll arkivit.pdf
51. Rregullore e mbrojtjes të dhënave personale_KUQ.pdf
52. Fletëpalosje Kolegjit Universitar “Qiriazit”.pdf
53. Udhëzim për kualifikimin e stafit akademik në KUQ.pdf
54. Pyetësori për Studentët dhe Stafit Pedagogjik.pdf
55. Plani i punës i NJSBC.pdf
56. Veprimtari te shoqatave te studenteve ne KUQ.pdf
57. Vendimi i Bordit të Administrimit për tarifa dhe bursa.pdf
58. Kartelë mjekësore e punëmarrësit për vlerësimin e riskut.pdf
59. Format i Dosjes personale të stafit akademik.pdf

60. Rregullore e Bordit të Administrimit.pdf
61. Plani buxhetor 2018-2025 për menaxhimin e institucionit.pdf
62. Plani buxhetor 2019-2021.pdf
63. Përdorimi i teknologjive të inovacionit dhe sistemi informatik në funksion të mësimdhënies.pdf
64. Rregullore e Sekretarisë Mësimore.pdf
65. Ekspertizë e ofruar nga ana e pedagogëve të KUQ për të tretë.pdf
66. Infrastruktura mësimore e KUQ.pdf
67. Raport Vlerësimi (Relacion i ambienteve mësimore të Kolegjit).pdf
68. Rregullore e Brendshme e Bibliotekës.pdf
69. Aktiviteti i Akademisë Shkencave për Sevasti Qiriazin e dhurimi i librave.pdf
70. Rregullore për ruajtjen dhe arkivimin e dokumentacionit.pdf
71. Modelet e Diplomave.pdf
72. Kriteret e pranimit të studenteve në KUQ 2019-2020.pdf
73. Modeli i dosjes së praktikës profesionale.pdf
74. Pyetësori i stafit akademik.pdf
75. Programi i punës për rregjistrimet_2018-2019&2019_2020 dhe komisionet e veçanta.pdf
76. Organigrama e Kolegjit Universitar "Qiriazin"
77. Për ndryshim Statuti për organigramën e IAL-së (shtojca 3) e Statutit të Kolegjit Universitar "Qiriazin"
78. Urdhër Nr.317 datë 2021-09-13 Për miratimin e një ndryshimi në statutin e Kolegjit Universitar "Qiriazin"
79. Fletëpalosje Kolegjit Universitar "Qiriazin".pdf

Shtojcat në gjuhën angleze:

80. Vendimi i Senatit për krijimin e SET-it institucional. ENG.pdf
81. Programet e studimit dhe diplomat në KUQ_2020-2021. ENG.pdf
82. Asambleja e Stafit Akademik të Fakultetit Ekonomik dhe Juridik. ENG.pdf
83. Funksionimi i Rektoratit. ENG.pdf
84. Këshilli i Etikës.ENG.pdf
85. Fakulteti Ekonomik. ENG.pdf
86. Departamenti i Menaxhimit të Biznesit. ENG.pdf
87. Departamenti i Financës. ENG.pdf
88. Fakulteti i Drejtësisë. ENG.pdf
89. Departamenti i të Drejtës Civile dhe Biznesit.ENG.pdf
90. Departamenti i të Drejtës Publike dhe Penale. ENG.pdf

91. Departamenti i Teknologjisë së Informacionit. ENG.pdf
92. Teknologjia e informacionit. ENG.pdf
93. Departamenti i Teknologjisë Ushqimore dhe Turizmit. ENG.pdf
94. Teknologjia Ushqimore. ENG.pdf
95. Hoteleri-turizëm. ENG.pdf
96. Kolegji i Lartë Profesional. ENG.pdf
97. Edukim Fizik dhe Sport. ENG.pdf
98. Qendra Kërkimore Shkencore e Fakultetit të Edukimit, Shkencave Sociale dhe Sporteve. ENG.pdf
99. Modeli i programit mësimor.pdf
100. Rregullorja e Senatit Akademik. ENG.pdf
101. Plani Strategjik i Zhvillimit të KUQ. ENG.pdf
102. Rregullorja e NjSBC-së. ENG.pdf
103. Rregullore e Zyrës së Marrëdhënieve me Jashtë, Pranimit dhe Këshillimit të Karrierës.ENG.pdf
104. Marrëveshje bashkëpunimi me institucionet homologe dhe aktorë të biznesit, brenda dhe jashtë vendit. ENGAL.pdf
105. Anketa e studentëve. ENG.pdf
106. Rregullorja e Këshillit Studentor. ENGAL.pdf
107. Rregullorja e Sekretarisë Mësimore. ENG.pdf
108. Rregullorja e brendshme e bibliotekës. ENG.pdf
109. Rregullore për ruajtjen dhe arkivimin e dokumentacionit.ENG.pdf

Lista B: Takimet e zhvilluara gjatë vizitës

- BM1: Grupi i vlerësimit të jashtëm u takua me Koordinatorin Institucional.
- BM2: Grupi i vlerësimit të jashtëm u takua me Rektoren.
- BM3: Grupi i vlerësimit të jashtëm u takua me një kampion studentësh të programeve Profesionale dhe Bachelor.
- BM4: Grupi i vlerësimit të jashtëm u takua me një kampion studentësh të ciklit të dytë.
- BM5: Grupi i vlerësimit të jashtëm u takua me një kampion të personelit mësimor.
- BM6: Grupi i vlerësimit të jashtëm u takua me një kampion të personelit mbështetës/administrativ.
- BM7: Grupi i vlerësimit të jashtëm u takua me Koordinatorin Institucional.
- BM8: Grupi i vlerësimit të jashtëm u takua me përfaqësuesit e zyrës së Burimeve Njerëzore.

- BM9: Grupi i vlerësimit të jashtëm u takua me menaxherët e lartë të universitetit.
- BM10: Grupi i vlerësimit të jashtëm u takua me Bordin e Administrimit.
- BM 11: Grupi i vlerësimit të jashtëm u takua me partnerë të jashtëm dhe alumni.
- BM12: Grupi i vlerësimit të jashtëm u takua me ekipin e vetëvlerësimit.
- Turne në objekt (FT)
- BM13: Grupi i vlerësimit të jashtëm u takua me Rektorin për të bërë një përmbledhje të linjave kryesore të vlerësimit dhe çështjet lidhura me të, që u ndoqën gjatë vlerësimit.

Lista C: Lista e dokumenteve të vëna në dispozicion gjatë vizitës

Lista e dokumenteve të vëna në dispozicion gjatë vizitës në terren. Këto dokumente mbi QAA janë referuar duke përdorur shkurtësën **C1...**, **C2..**, etj:

1. Evidenca me dokumenta konkretë për hapat që janë ndjekur për plotësimin e secilit rekomandim të dhënë nga Bordi Akreditimit..pdf
2. Listë e plotë e anëtarëve të Senatit Akademik.pdf
3. Evidenca që znj. Alketa Stafuka ka qenë prezente në një mbled.pdf
4. Evidencë për investimin e kryer për pasurimin e IAL-së.pdf
5. Kuotat e parashikuara dhe ato të plotësuara për të gjithë nj.pdf
6. Ngarkesa mësimore për stafin akademik për vitin akademik 2020-.pdf
7. Lista e stafit dhe ndryshimet e pësura për 3 vitet e fundit. .pdf
8. Për stafin akademik me gradën Prof. As. dhe lart listën emëro.pdf
9. Shembull të një njoftimi pune për rekrutimin e stafit akademi.pdf
10. Sasinë e kompjuterave që disponojnë laboratorët e juaj.pdf
11. Shkresat e vitit të fundit drejtuar QSHA për pajisjen me regjistrin e diplomave, korrespondencën mes dy institucioneve..pdf
12. Analiza e Senatit Akademik rreth përmbushjes së rekomandimev.pdf
13. Raporti i punës kërkimore shkencore paraqitur nga Qendra e Kërkimit Shkencor.pdf
14. Kërkesa dhe miratimi nga Bordi Administrimit për fondin e kërkimit shkencor me verë 24000 euro..pdf
15. Evidencë për 3 mbledhjet e fundit të Senatit Akademik dhe Bordit të Akreditimit..pdf
16. Listën e këshilltarëve të jashtëm të Bordit të Administrimit.pdf
17. Cilat janë 5 IAL-të kombëtare dhe 2 ndërkombëtare që përmenden nga ju në RVB që ju keni krijuar lidhje të ngushta..pdf
18. Evidencë të saktë të numrit të PAE_PAK_ADMINISTRATIV.pdf
19. Një praktikë të procedurës së transferimit te studenteve.pdf